



**PËR AZILKËRKUESIT**




Foto: Scandinav Bildbyrå / Jörgen Wiklund

# **Kështu vepron nëse ke nevojë për kujdes shëndetësor ose kujdes dentar**

## QENDRA SHËNDETËSORE — NËSE **NUK** JE I/E SËMURË RËNDË OSE I/E LËNDUAR

Nëse ke telashe që nuk kanë nevojë për kujdes të menjëhershëm në spital, atëherë kërko ndihmë në qendrën shëndetësore. Qendrat shëndetësore janë hapur në mes orës 08.00 dhe 17.00, çdo ditë pune. Për të shkuar atje, duhet të telefonosh dhe të caktosh kohën.

Të dhënat e kontaktit për qendrën shëndetësore:



## 1177 UDHËRRËFYES I KUJDESIT SHËNDETËSOR — NËSE KE NEVOJË PËR KËSHILLA DHE KUJDES SHËNDETËSOR

Nëse telefonon në numrin 1177, do të flasësh me një infermiere të telefonisë. Infermierja e telefonisë mund të përgjigjet në pyetjet, të jep këshilla, vlerëson nëse ke nevojë për kujdes shëndetësor dhe në rast nevoje, të udhëzon ku do të shkosh. Ti mund të telefonosh 1177 në çdo kohë, ditën dhe natën. Ka mundësi të flasësh edhe përmes përkthyesit. Ti, po ashtu, mund të gesh këshilla në internet. Në [www.1177.se](http://www.1177.se) ka tekste mbi sëmundjet, shqetësimet, kontrollimet dhe trajtimet. Disa nga tekstet janë të përkthyera në gjuhë të ndryshme.

## NJËSIA E PRANIMIT URGJENT — NËSE JE I/E SËMURË RËNDË OSE I/E LËNDUAR

Nëse ti papritmas ke një sëmundje të rëndë ose je i/e lënduar në një aksident, duhet të shkosh në njësinë e pranimit urgjent në spitalin e Östersund-it. Njësia e pranimit urgjent është hapur, të gjitha ditët, ditën dhe natën.

**Nëse shtrihesh në spitalin e Östersund-it, është shumë me rëndësi që ti ose dikush nga personelit të njoftojnë Entin e Migracionit në Östersund.**

**Numri i telefonit i Entit të Migracionit është 010-485 54 18.**

## KUJDESI DENTAR — NËSE TË DHËMBIN DHËMBËT

Fëmijët të cilët kërkojnë azil kanë të drejtë në kujdes dentar, si të gjithë fëmijët e tjerë në Suedi. Ti je fëmijë nëse nuk i ke mbushur 18 vjet.

Azilkërkuesit e rritur kanë të drejtë vetëm në kujdes dentar urgjent. Domethënë nëse ke temperaturë, ënjtje, dhembje dhe trauma (nëse je goditur në gojë).

Fëmijët thirren automatikisht në Kujdesin dentar popullor, për kontrollime në atë qytet ku banon fëmija. Nëse fëmija ka nevojë për kujdes urgjent dentar, telefononi numrin kujdestar të Kujdesit dentar popullor, 063-15 33 00.

Të rriturit që kanë nevojë për kujdes urgjent dentar, duhet, po ashtu, të telefonojnë në numrin kujdestar të Kujdesit urgjent dentar. Duhet gjithmonë të telefononi dhe të porositni kohën, para se të shkoni atje, për kujdes urgjent dentar.

---

## TË DREJTAT PËR KUJDES SHËNDETËSOR DHE KUJDES DENTAR

Fëmijët azilkërkues (më të rinj se 18 vjeç), kanë të drejtë për kujdes shëndetësor dhe kujdes dentar që ata kanë nevojë, në të njëjtat kushte si fëmijët e tjerë që banojnë në Suedi.

Të rriturit azilkërkues (mbi 18 vjeç), kanë të drejtë për kujdes urgjent shëndetësor, kujdes urgjent dentar, kujdes shëndetësor për nënat, kujdes shëndetësor në rast lindje, këshilla për mjete kontraceptive, abort, kujdes shëndetësor sipas ligjit të mbrojtjes ndaj infeksioneve, si dhe kujdes shëndetësor të ngutshëm (që nuk pret).

**Mos harro se ti gjithmonë duhet të tregosh dëftesën e azilit ose kartën LMA, kur ti i drejtohesh kujdesit shëndetësor dhe kujdesit dentar, si dhe kur i blenë ilaçet me recetë.**

---

## KONTROLLIM SHËNDETËSOR

Të gjithë azilkërkuesit kanë të drejtë të bëjnë një kontrollim falas shëndetësor. Shfrytëzo me dëshirë këtë mundësi.

---

## PËRKTHYES

Ti ke gjithmonë të drejtë të kesh përkthyes kur ke kontakt me kujdesin shëndetësor dhe kujdesin dentar. Nëse ke një kohë të caktuar në qendrën shëndetësore, në spital ose te kujdesi dentar, është me rëndësi të vish në kohë të caktuar, pasi që për atë vizitë është porositur përkthyesi.

---

## KOSTOJA E VIZITËS NË KUJDESIN SHËNDETËSOR DHE KUJDESIN DENTAR

Fëmijë dhe të rinjtë që nuk kanë mbushur 20 vjet, kanë kujdes shëndetësor falas.

Personat të cilët i kanë mbushur 20 vjet paguajnë:

- 25 korona për vizitë tek një infermiere e rajonit në një qendër shëndetësore
- 50 korona për vizitë tek mjeku në një qendër shëndetësore
- 50 korona për vizitë një njësinë e pranimi urgjent të spitalit, nëse ke qenë më parë në qendrën shëndetësore dhe ke marrë një udhëzim. Nëse nuk ke një udhëzim, vizita në njësinë e pranimi urgjent kushton 300 korona.

Fëmijët dhe të rinjtë që kërkojnë azil, mund të kenë kujdes dentar falas. Kjo vlen deri në moshën 18 vjeç. Të rriturit që kanë mbushur 18 vjet dhe kërkojnë azil, mund të kenë kujdes urgjent dentar, nëse kanë temperaturë, ënjtje, dhembje dhe trauma (nëse je goditur në gojë). Një vizitë kushton 50 korona.

## NËSE MBETESH SHTATZËNË

Kontakto qendrën shëndetësore sapo të dish se je shtatzënë. Ti ke të drejtë të bësh kontrollime të rregullta tek mamia. Nëse ke nevojë, të mundësojnë kontaktin me mjekun. Ti, po ashtu, merr informacion në prag të lindjes, merr kujdes shëndetësor gjatë lindjes dhe bën kontrollimin tënd dhe të fëmijës, pas lindjes. Ti, po ashtu, mund të marrësh këshilla për mjetet kontraceptive. Për këtë kujdes shëndetësor, nuk do të paguash ndonjë tarifë.

---

## ABORT

Sipas ligjit suedez, është gruaja e cila vendosë vet nëse ajo dëshiron të bëjë abort apo jo. Gratë të cilat dëshirojnë këshilla mbi abortin, duhet të caktojnë kohën në Njësinë pranuese të abortit në spitalin e Östersund-it. Janë dy numra telefonash atje:

Në 063-15 39 30 mund të telefonosh të hënave, të martave dhe të mërkurave, në mes orës 08.00 dhe 09.00.

Në 063-15 35 93 mund të telefonosh të enjteve dhe të premteve, në mes orës 08.00 dhe 09.00.

---

## UDHËTIMI

Ti kujdesesh vet për transportin për në kujdesin shëndetësor dhe kujdesin dentar dhe anasjelltas. Nëse personeli i kujdesit shëndetësor konsideron se je shumë i/e sëmurë dhe ke nevojë të udhëtosh me taksi veturë, atëherë personeli e shkruan një vërtetim dhe e porosisin një taksi veturë për ty. Udhëtimi kushton 40 korona. Ti ia paguan tarifën shoferit të taksi veturës, para nisjes.

---

## ILAÇET

Nëse ke nevojë për ilaçe, duhet të blesh ato në barnatore, ashtu si ka vendosur mjeku yt. Nëse ke marrë recetë për një ilaç dhe e tregon kartën tënde LMA kur shkon ta marrësh ilaçin, në atë rast ti paguan 50 korona. Nëse blenë ilaçe pa recetë, ti e paguan atë çmim që zakonisht kushton ilaçi.

---

## E DREJTA PËR KOMPENSIM

Kursej të gjitha faturat që merr kur ti viziton kujdesin shëndetësor ose kujdesin dentar, kur blen ilaçe me recetë dhe kur udhëton në rast sëmundje. Nëse ti, brenda gjashtë muajsh, ke paguar më shumë se 400 korona, mund të kërkosh një shtesë të veçantë tek Enti i Migracionit. Ti merr kompensim për shpenzimet që tejkalojnë 400 korona. Nëse p.sh. ke paguar 600 korona, atëherë ti merr kompensim 200 korona.